

BOJAKËT



ULTRAFUGA

2-15mm

Ngjyra	Paketimi
26 ngjyra	2KG & 5KG

PËRSHKRIM

Bojak me bazë çimento për mbylljen e fugave, me elasticitet të lartë, i përbërë nga rërë mermeri të cilësisë së lartë me granulometri të seleksionuar, përmbajtje të lartë rezinash sintetike dhe agjentë hidrofobikë. Ofron rezistencë të lartë ndaj lagështirës dhe abrazionit.

I përshtatshëm për mbushjen e fugave nga 2-15mm. I klasifikuar si produkt CG2 në bazë të standartit EN 13888. Karakterizohet nga një punueshmëri shumë e mirë, pas-trim shumë i lehtë, ngjijtje shumë e mirë, qëndrueshmëri të lartë ndaj rrezeve të diellit dhe agjentëve atmosferikë, ka aftësi të ruajtje ngjyrat, rezistent ndaj agjentëve gërryes, acideve dhe bazave të ndryshme. I disponueshëm në 26 ngjyra.

FUSHA E APLIKIMIT

ULTRAFUGA përdoret për stukimin e pllakave prej qeramike, gres porcelani, pllaka mozaiku për ambiente të jashtme dhe të brendshme. I rekomandueshëm për mbylljen e fugave në ambiente ku ka vibrime, në ambiente me ngrohje qëndrore dhe tarraca. Nuk rekomandohet për mbushjen e fugave në gjerësi më të mëdha se ajo e lejuar. Në rast aplikimesh për zona të ekspozuara me trafik të lartë ose nën ndikimin e kimikateve propozojmë që produkti të përfordhet me FUGALASTIC deKoll.

PËRGATITJA E BAZAMENTIT


Fugat që do të stukohen duhet të jenë të pastra, pa ngjijtës pllakash ose llaç në të gjithë trashësinë. Nuk rekomandohet aplikimi mbi bazamente të lagura.

PËRGATITJA E PRODUKTIT

Përzjeni 1.2-1.6 litër ujë me një qese 5 kg produkt pluhur në një enë të pastër me një përzjerës elektrik derisa të arrini një masë homogjene dhe pa kokrriza. Duhet marrë parasysh që materiali i përzjerë për stukimin e fugave në dysheme bëhet me ujë më pak se sa për fugat në mure.

APLIKIMI





Aplikoni produktin në fuga me një shpatull gome ose me makinerinë shpatulluese. Pas 20 min kur produkti të jetë bërë i qëndrueshëm bëhet pastrimi i pjesës së mbetur me një sfungjer në menyrë transversale me drejtimin e fugave.



PLLAKA		KONSUMI NË VARËSI TË GJERËSISË SË FUGAVE					
		2 mm	4 mm	6 mm	10 mm	12 mm	15 mm
2 x 2	kg/m²	1.00					
5 x 5	kg/m²	0.85	1.75				
10 x 10	kg/m²	0.40	0.85	1.30	2.20		
7.5 x 15	kg/m²	0.40	0.85	1.30	2.20		
12 x 24	kg/m²	0.25	0.70	1.05	1.75	2.10	2.45
15 x 15	kg/m²	0.25	0.55	0.85	1.45	1.75	2.05
20 x 20	kg/m²	0.25	0.55	0.85	1.40	1.65	1.95
20 x 30	kg/m²	0.20	0.45	0.70	1.15	1.40	1.65
30 x 30	kg/m²	0.15	0.35	0.55	0.95	1.15	1.35
40 x 40	kg/m²	0.10	0.25	0.40	0.70	0.85	1.00
50 x 50	kg/m²	0.10	0.20	0.35	0.60	0.75	0.90
60 x 60	kg/m²	0.05	0.15	0.25	0.45	0.55	0.65

TË DHËNAT TEKNIKE

Pamja: Pluhur	Mbushja e fugave në mure: Pas 4-8 orësh
Paketimi: Qese 2 kg ne kuti nga 16 kg mbi paletë prej 576kg (36 kuti) dhe 5kg ne kuti nga 20kg mbi paletë prej 720kg (36 kuti)	Mbushja e fugave në dysHEME: Pas 24 orësh
	Pastrimi i fugave: Pas 20 minutash
Ngjyra: I disponueshëm në 26 ngjyra	I shkëlshëm: Pas 24 orësh
Magazinimi: Të ruhet në vende të thata mbi paleta druri	Rezistenca në shtypje në 28 ditë: 30N/mm ²
Koha e magazinimit: 12 muaj nga data e prodhimit	Rezistenca në përkulje në 28 ditë: ≥ 3.5 N/mm ²
Masa Vëllimore: 1.4 gr/cm ³	Rezistent ndaj: Acideve
Ujë për përzierje: 1.2-1.6 litra ujë për 5 kg	Absorbimi i ujit pas 30 minutash: ≤ 2 g
pH i përzierjes: 13	Absorbimi i ujit pas 240 minutash: ≤ 5g
Temperatura e aplikimit: +5°C deri në +35°C	Tërheqja: ≤ 3 mm
Koha e punueshmërisë: 2 orë	Rezistenca termike: - 30°C / + 80°C



Kujdes! Për suporte ku është kaluar hidroizoluesi dhe formate të mëdha pllakash vendosja e fugës bëhet 4-5 ditë pas aplikimit të kollës, në fund të bashkimit me murin aplikohet silikon me të njëjtën ngjyrë me fugën.